

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Afrim Shala, me sekretaren juridike Mejreme Tahiri, në çështjen penale ndaj të pandehurit D. Q., nga fshati T, Komuna e V., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës,<sup>1</sup> të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati B. K., nga Gj., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gj., Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.73/2016, e datës 31 mars 2016, të cilën e përfaqësonte prokurori Shaban Spahiu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 10 maj 2016, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa, më datë 11 maj 2016 e përpilojë me shkrim këtë :

## A K T G J Y K I M

I pandehuri D. Q., nga babai R. dhe nëna F., e lindur A., i lindur më ..., në fshatin T., Komuna e V., ku edhe tani jeton, shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, i martuar, me profesion bujk, i gjendjes së varfër ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale,

## Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse në kohën e pavërtetuar më parë, pa autorizim dhe pa leje valide, në kundërshtim me ligjin për armët, ka siguruar dhe mbajtur në pronësi armën e zjarrtë një revole e markës "...", prodhim Jugosllav, e kalibrit ...mm, me numër serik ..., me ... fishekë të kalibrit ... mm dhe ... karikator, ndërsa, në objektin përcjellës të shtëpisë së tij po ashtu është gjetur një granatë dore ... me ngjyrë të gjelbër, e që edhe me datën e lartcekur, me rastin e kontrollimit të shtëpisë së tij dhe objekteve përkatëse nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, i gjendet arma e lartëcekur, municioni dhe të njëjtat i sekuestrohen, si dhe poashtu janë njoftuar edhe ekipi i Forcës së Sigurisë së Kosovës për deminim dhe të njëjtit kanë marrë granatën e dorës për deminim,

-me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Andaj, kryetari i trupit gjykues, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 46, 62 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 6, 69, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 248 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,<sup>2</sup> të pandehurit D. Q., i shqipton :

## DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit D. Q., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind Euro), të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat prej 3 (tre) muajve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të barazohen me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Konfiskohet arma e zjarrit e markës "...", e prodhim Jugosllav, e kalibrit ... mm, me numër serik ..., ... fishekë të kalibrit ... mm, me tre karikator dhe ... granatë dore.

Detyrohet i pandehuri që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzetepesë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

## ARSYETIMI

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gj., Departamenti i Krimeve të Rënda, më 31 mars 2016 ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit D. Q., nga fshati T., Komuna e V., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Pas pranimit të aktakuzës, kryetari i trupit gjykues e ka caktuar shqyrtimin fillestar për datën ..., ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

### 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

---

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshme KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësin e tij, avokatin B. K., se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri D. Q., me dashje e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 374 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, e kryen “kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë deri në 7.500 € (shtatë mijë e pesëqind Euro) ose me burgim deri në 5 (pesë) vjet”. Ndërsa, në Ligjin për armët,<sup>3</sup> është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë, duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent. Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, kryetari i trupit gjykues, e ka shpallur fajtor të pandehurin D. Q., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe penalisht përgjegjës.

### 5. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që të pandehurin D. Q., t'a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së lartcekur.

### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, kryetari i trupi gjykues i ka marrë për bazë sjelljet e mira të pandehurit gjatë shqyrtimit fillestar; pranimin e fajësisë; se i njëjti është penduar për kryerjen e

<sup>3</sup> Ligji nr.05/L-22 për Armët, i datës 23 korrik 2015.

kësaj veprë penale; se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë veprë tjetër penale, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë tjetër penale. Gjithashtu, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të pandehurit dhe të ardhurat e tij.

#### 7. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimi me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind Euro) ndaj të pandehurit D. Q., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 8. Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Kryetari i trupit gjykues duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'ua paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të barazohen me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

#### 9. Dënimi plotësues

Përveç dënimit kryesor, duke u bazuar në nenet 62, 69 dhe 374 paragrafi 3 të KPRK, ndaj të pandehurit D. Q., shqiptohet edhe dënimi plotësues marrja - konfiskimi i armës së zjarrit e markës "...", me numër serik ... e prodhim Jugosllav, e kalibrit ... mm, ... fishekë të kalibrit ...mm, ... karikatorë, si ... granatë dore ....

#### 10. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë që ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzetepesë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Krimeve të Rënda  
Më 11 maj 2016

Sekretarja juridike,  
Mejreme Tahiri

Kryetari i trupit gjykues,  
Afrim Shala

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.